



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-103
Prishtinë, më 6 maj 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 6 MAJ 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku, Nexhat Daci dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Xhezair Murati dhe Branslav Grbiq;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati
Nga ICO, Blerta Bejtullahu dhe
Nga OSBE, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe pesë pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d t ë d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 prill 2010,
2. Plotësimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, më 13 maj 2010,
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 prill 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 prill 2010, u miratua pa vërejtje.

Sabri Hamiti pati vërejtje në transkript, ngase ishte evidencuar gabimisht se është miratuar procesverbali i mbledhjes së Kryesisë i datës 13 maj 2010, ndërsa duhej të ishte “miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të datës 28 prill 2010.

Ibrahim Makolli, po ashtu, pati vërtetje në transkript, në faqen e fundit 10, ku gabimisht ishte evidencuar: ”varet sa do të jetë pjesëmarrja e opozitës në numër”, ndërsa duhej të ishte “e **pozitës**”.

Transkripti është korrigjuar, sipas vërejtjeve të dhëna më lart.

2. Plotësimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, më 13 maj 2010

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që rendi i ditës i seancës së Kuvendit, që do të mbahet më 13 maj 2010, të plotësohet edhe me këto pika.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për eficientësinë e energjisë,
4. Shqyrtimi i Propozim-amendamenteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar,
5. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2009,
6. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2009,
7. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore.

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi Raportin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që ta shqyrtojë Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2009, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.2 Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

Kryesia, pasi shqyrtoi Raportin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, që ta shqyrtojë Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, për vitin 2009, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.3 Shqyrtimi i Raportit të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi Raportin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, që ta shqyrtojë Raportin e Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian, për vizitë zyrtare në Parlamentin e Republikës së Estonisë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian, në këtë përbërje: Zylfije Hundozi, Fatmir Rexhepi, Nait Hasani, Njomza Emini dhe Petar Miletqi, si dhe Ahtere Loxha, nga stafi mbështetës i Komisionit, në Parlamentin e Republikës së Estonisë, prej 18 deri më 23 maj 2010.
2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i mbulon organizatori - OSBE-ja, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.5 Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë Nationale të Francës për grupin e deputetëve të Kuvendit për vizitë zyrtare

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje të këtyre deputetëve: Hydajet Hyseni, Gani Koci, Ismet Beqiri, Nerxhivane Dauti, Kosara Nikoliq, Esat Brajshori dhe Shpresa Murati, në Asamblenë Nationale të Francës, prej 17 deri më 20 maj 2010.
2. Shpenzimet e qëndrimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori - OSBE-ja, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për vizitë zyrtare në Parlamentin e Estonisë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në këtë përbërje: Naser Rugova, Berat Luzha, Myrvete Pantina dhe Branislav Grbiq, në Parlamentin e Republikës së Estonisë, prej 18 deri më 23 maj 2010.
2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori - OSBE-ja, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Bujar Dugolli, për vizitë zyrtare në Romë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputetit Bujar Dugolli në Romë, Itali, që të marrë pjesë në punimet e Këshillit të Përgjithshëm të Partisë Radikale Kundër Dhunës, prej 27 deri më 31 maj 2010.
2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurin, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i mbulon organizatori, ndërsa shpenzimet e transportit dhe mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.9 Njoftimi i Grupit Parlamentar për Integritet për zëvendësimin e kryetarit të Grupit.

Kryesia u njoftua me propozimin e Grupit Parlamentar për Integritet për zëvendësimin e kryetarit aktual, Numan Baliq me deputetin Branisllav Grbiq.

3.10 Njoftimi i deputetes Njomza Emini për ndërrimin e Grupit Parlamentar.

Kryesia u njoftua se deputetja Njomza Emini kishte kaluar nga Grupit Parlamentar i AKR-së, në Grupin Parlamentar të LDK-së.

3.11 Njoftimi i deputetes Melihate Termkolli për ndërrimin e Grupit Parlamentar.

Kryesia u njoftua se deputetja Melihate Termkolli kishte kaluar nga Grupit Parlamentar i LDK-së, në Grupin Parlamentar të AAK-së.

Të ndryshme

Naim Maloku ngriti çështjen e debatit të seancës së mëparshme, ku ishte diskutuar për Raportin e Trustit Pensional të Kosovës. Ai shtoi se vërejtjet kryesore që janë dhënë nga deputetët për atë raport kanë qenë: a) mjetet e Trustit që janë investuar jashtë vendit, duhen të kthehen në tregun e kapitalit brenda vendit, dhe b) pagat e larta të të punësuarve në Trust.

Kuvendi nuk e ka miratuar Raportin e Trustit, por sipas ligjit aktual, Trusti ka të drejtë për veprimet që i ka bërë dhe që janë cekur në raport. Andaj, për të dalë nga kjo situatë, propozoj që Kuvendi të marrë nismën ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit aktual.

Në diskutim morën pjesë: Ibrahim Makolli, Safete Hadërgjonaj, Nexhat Daci, Sabri Hamiti dhe kryetari Jakup Krasniqi.

Kryesia, pas këtyre diskutimeve, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të marrë nismën ligjvënëse për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, nr 03-L-084 për Fondin Pensional të Kosovës.
2. Kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta formojë një grup të punës për t'i analizuar përvojat e vendeve të rajonit për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të kursimeve pensionale dhe Kuvendit t'ia paraqesë një raport me rekomandime për veprime të mëtejme.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale